

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit Programi: Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit
Titulli i lëndës:	Vlerësimi i rrezikut dhe analiza e vendimeve
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	-II-
Semestri:	-III-
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi:	6
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda ofron njohuritë themelore mbi menaxhimin e rrezikut dhe vendimmarrjes, problemet me të cilat ballafaqohen menaxherët në organizate ndërmarrëse, banka dhe kompani të sigurimeve dhe në ndërmarrjet tjera afariste inovative. Vlerësimi i Rrezikut dhe Analiza e Vendimeve do të ofroj një qasje të thelluar dhe analitike për të kuptuar procesin e identifikimit, vlerësimit, dhe menaxhimit të rreziqeve në një kontekst të zgjeruar organizativ.</p> <p>Në këtë kurs, studentët do të eksplorojnë teknikat dhe mjete të ndryshme për të përcaktuar rreziqet potenciale, vlerësuar ndikimin e tyre, dhe marrë vendime të informuara për menaxhimin e tyre efektiv.</p> <p>Programi i kësaj lënde do ti njoftoi studente me menaxhimin e rrezikut vendimmarrës dhe ndikimi i tyre ne rezultatin final, duke ndërmarrë veprime për të trajtuar rreziqet afariste që luajnë një rol të rëndësishëm.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njohuri e fituara përmes kësaj lënde, kanë për qëllim qe studentët të përfitojnë dijen mbi konceptin e fushës së menaxhimit të rrezikut dhe vendimmarrjes.</p> <p>Përmes secilës synohet, që studentët të thellohen me njohuri themelore mbi konceptet e menaxhimit të rrezikut dhe vendimeve, duke përfshirë rreziqet specifike që shfaqen në kontekstin e ndërmarrësisë dhe inovacionit.</p> <p>Përgatitja e studentëve për të ofruar zgjidhje konkrete dhe efektive për sfidat e menaxhimit të rrezikut në banka, sigurime dhe në kompanitë e tyre të mundshme</p> <p>Ky kurs ka për qëllim të përgatisë studentët për të kuptuar, identifikuar, menaxhuar dhe vlerësuar rreziqet dhe sfidat e menaxhimit të në ambientin biznesor.</p>
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<p>Pas përfundimit të lëndës, studenti duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezanton konceptet themelore të menaxhimit të rrezikut • Ndërton njohuri te avancuara për menaxhimin e rrezikut ne ndërmarrje • Analizon drejt problemet praktike të menaxhimit të rrezikut

	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon problemet me të cilat ato ballafaqohen me rreziqet vendimmarrëse • Krijon aftësi dhe komotence mbi menaxhimin e Rrezikut ne Banka dhe Sigurime • Posedon shkathtesi për identifikim dhe dallim të rreziqeve të ndryshme, në ndërmarrje • Aplikon njohuritë e fituara në zgjidhjen e problemave praktike. • Kupton se si të menaxhoi Vlerësimi e rrezikut dhe analizën e vendimeve, 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrimet teorike/detyra	2	5	10
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	5	5
Kollokuium – seminar			
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45
Përgatitja përfundimtare në provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1	5
Projektet, prezantimet etj	1	10	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	<p>Ligjërata interaktive me studente lidhur me temat e ligjëruara, orientimi ne shtjellimin e materialit, diskutime grupore per përdorimin e metodave te avancuara ne praktike.</p> <p>Angazhimi ne raste studimore dhe zgjedhje te detyrave duke u bazuar ne ligjërata.</p> <p>Zhvillimi i interaktivitetit me studentin ne qendër duke trajtuar rastet analitike dhe njohurit rreth fushës së vlerësimit të rrezikut dhe analizës së vendimeve.</p>		
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	<p>Vlerësimi dhe forma e ndërtimit të notës për studentet do të mbështetet në tre aktivitetet e mëposhtme:</p> <p>1. Aktiviteti dhe angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme,</p> <p>Aktiviteti ne mësim - nënkupton që studentin te jetë aktive dhe i përfshirë ne diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema te reja qe janë te ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim te nxitjes se debatit gjate ligjëratave.</p>		

	<p>Angazhimi - nënkupton qe studenti ti kryej dhe prezantoj detyrat qe caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese.</p> <p>2. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 30 pikë nga 100 pikët e mundshme, Brenda semestrit studenti duhet te përgatit një rast studimi detyre, projekt/punim seminarik i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Tema e punimit mund te propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet te jete ne korrelacion te plote me lenden.</p> <p>3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë nga 100 pikët e mundshme, Brenda semestrit parashihet - sipas rrethanave të behet vlerësimi për angazhimin e studentit, po ashtu do ti nënshtrohet provimit final me shkrime. Studenti do t'i nënshtrohet testit te provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit. Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies se parapare për materialin e lendes se ligjësuar. Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet ne mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyetje objektive, te njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës, • pyetje subjektive te llojit ese/detyre me shkrim për te cilat vete studenti duhet te jete ne gjendje te jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lendes se ligjësuar, te njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit. <p>Studentët pasi i nënshtrohen provimit, do të ndërtojnë notën përfundimtare si me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • max 10 pikë - aktiviteti dhe angazhimi në mësim, • max 30 pikë- hartimi dhe prezantimi i detyrës, projektit, punimi/hulumtimit, • max 60 pikë - provimi final, <p>Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga te gjitha kriteret e vlerësimit,</p>
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - teori 30% - ushtrime praktike,

Literatura	
Literatura bazë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Norman Fenton & Martin Neil: Risk Assessment and Decision Analysis with Bayesian Networks, 2nd Edition, First Published 2018. 2. Orfea Dhuci, Njohuritë bazë për riskun dhe drejtimin e tij, Ombra GVG, Tiranë, 2011.
Literatura shtesë	<ol style="list-style-type: none"> 1. George E. Rejda, Principles of Risk Management and Insurance, 10th Edition, Addison Wesley, Boston, 2008
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	
	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	<p>Prezantimi – njohimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Përshkrimi i lëndës Qëllimet e lëndës Rezultatet e pritura të mësimit: Metodologjia e mësimit dhe (mësimit) Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë) Prezantimi i literaturës Rezultati i pritur nr.1</p>
Java e dytë	<p>Njohuritë dhe qasjet në definimin e rrezikut vlerësimi i rrezikut dhe analiza e vendimeve Njohuritë rreth zhvillimit të rrezikut Përshkrimi i rreziqeve të mundshme që organizatat mund të përballojnë, përfshirë rreziqet financiare, operacionale, dhe strategjike. Rezultati i pritur nr.2</p>
Java e tretë	<p>Nocionet lidhur me vlerësimin e rrezikut dhe analiza e vendimeve Prezantimi i koncepteve themelore të vlerësimit të rrezikut Metodat dhe mjetet për identifikimin e rreziqeve potenciale dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në objektivat e organizatës. Rezultati i pritur nr.3</p>
Java e katërt	<p>Klasifikimi i rrezikut në vendimmarrje Menaxhimi i rrezikut në vendimmarrje Përdorimi i analizës së kostove dhe avantazheve për të krahasuar dhe vlerësuar opsionet e ndryshme të lidhura me menaxhimin e rreziqeve në vendimmarrje Rezultati i pritur nr.4</p>
Java e pestë	<p>Llojet e rreziqeve të pastra dhe vlerësimi në mjedisin biznesor Analizimi i drejt i problemeve praktike të menaxhimit të rrezikut Zhvillimi i matricave të prioritetit për të përcaktuar rëndësinë e rreziqeve dhe caktuar nivelet e ndërhyrjes Rezultati i pritur nr.5</p>
Java e gjashtë	<p>Rëndësia e teknologjisë në menaxhimin dhe vlerësimin e rrezikut Teknologjia dhe menaxhimi i rrezikut periodik Problemet me të cilat ato ballafaqohen me rreziqet vendimmarrëse Përdorimi i teknologjisë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive. Rezultati i pritur nr.6</p>
Java e shtatë	<p>Fazat e procesit të menaxhimit, vlerësimit të rrezikut Identifikimi i rreziqeve potenciale që mund të ndikojnë në objektivat dhe projektet e organizatës.</p>

	<p>Vlerësimi i ndikimit të mundshëm të rreziqeve dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre.</p> <p>Zhvillimi i strategjive dhe planeve për menaxhimin e rreziqeve të identifikuar.</p> <p>Implementimi i strategjive dhe kontrolli për menaxhimin e rreziqeve.</p> <p>Rezultati i pritur nr.4,6,7</p>
Java e tetë	<p>Risqet dhe dëmet në kushtet e globalizimit dhe ndryshimeve klimatike</p> <p>Menaxhimi i ndryshimeve klimatike, rreziqe nga rritje të temperaturave, motit ekstremë, zbutje të akullnajave, dhe ndryshime në regjimet e reshjeve.</p> <p>Menaxhimi i rreziqeve nga humbje të pronës, infrastrukturës, rritja e kostos për ndërtim dhe riparime.</p> <p>Menaxhimi i rreziqeve nga Epidemitë dhe pandemitë</p> <p>Rezultati i pritur nr.5,7</p>
Java e nëntë	<p>Përkufizimi dhe menaxhimi dhe vlerësimi të rrezikut financiar dhe bankar</p> <p>Menaxhimi i rreziqeve kreditore nga mundësitë e humbjeve financiare nga klientët që nuk i kthejnë kredinë.</p> <p>Menaxhimi me rreziqet të likuiditetit aftësinë e një banke për të përballuar detyrimet e saj financiare.</p> <p>Rezultati i pritur nr.6,7</p>
Java e dhjetë	<p>Menaxhimi dhe vlerësimi i rrezikut të tregut dhe vendimmarrjes</p> <p>Analiza e Tregut, identifikimi i tendencave, shpërndarjes së klientëve, dhe zhvillimet e mundshme në treg që mund të ndikojnë në aktivitetet e organizatës.</p> <p>Konkurrencën dhe Dinamikën e Tregut, vlerësimi i rivalitetit me konkurrentët dhe ndryshimet në dinamikën e tregut që mund të sjellin mundësi ose rreziqe.</p> <p>Analiza e Ndikimit dhe Probabilitetit: Përdorimi i analizës sa ka një rrezik mundësi për të ndodhur.</p> <p>Analiza e tregut të siguruar dhe të pa siguruar: Identifikimi i rreziqeve</p> <p>Përdorimi i modeleve të rreziqeve për vendimarrje.</p> <p>Rezultati i pritur nr.7,8,</p>
Java e njëmbëdhjetë	<p>Menaxhimi i rrezikut të portofolit</p> <p>Analiza e Varësisë së Aktiviteteve të vlerësuar se si ndryshimet në vlerën e një aktiviteti ndikojnë në vlerën e portofolit.</p> <p>Stres Testimet për të vlerësuar performancën e portofolit në skenarët më të rënda të mundshme të tregut.</p> <p>Analiza e Korelacioneve: për të kuptuar se si investimet ndërveprojnë ndërmjet tyre në situata të ndryshme tregu.</p> <p>Diversifikimi i Portofolios përmes investimeve në një gamë të gjerë të klasave të ndryshme të asetëve për të zvogëluar rreziqet e specifikuar.</p> <p>Rezultati i pritur nr.8</p>
Java e dymbëdhjetë	<p>Menaxhimi i rrezikut dhe vlerësimi nëpërmjet sigurimit</p> <p>Identifikimi i Rreziqeve Specifike të mundshme që organizata apo individët mund të ballafaqohen me to, përfshirë rreziqet e dëmeve materiale, shëndetësore, dhe financiare.</p> <p>Zgjedhja e Produkteve dhe Polisave të Sigurimit:</p> <p>Sigurimi i Pronësisë dhe Përdorimit i polisave të sigurimit për të mbuluar humbjet materiale.</p>

		<p>Përdorimi i polisave të sigurimit shëndetësor dhe humbjeve të të ardhurave gjatë sëmundjeve ose aksidenteve.</p> <p>Vlerësimi i Premies dhe Limitit të Siguruar:</p> <p>Vlerësimi i Kostos së Sigurimit: Analiza e kostos së sigurimit në krahasim me rrezikun dhe vlerën e mbuluar për të siguruar një zgjedhje të përshtatshme.</p> <p>Rezultati i pritur nr.1,2,3</p>
	Java e trembëdhjetë	<p>Menaxhimi i rrezikut nëpërmjet sigurimit, studime të rasteve nga studentet, analizimi dhe vlerësimi</p> <p>Studime të rasteve rreth menaxhimit, vlerësimit të rrezikut dhe analizës së vendimeve</p> <p>Rezultati i pritur nr.4.5.6</p>
	Java e katërbëdhjetë	<p>Menaxhimi i rrezikut nëpërmjet sigurimit, studime të rasteve nga studentet, analizimi dhe vlerësimi i sigurimi të pronës, profesionit, jetës, etj.</p> <p>Studime të rasteve rreth menaxhimit, vlerësimit të rrezikut dhe analizës së vendimeve</p> <p>Rezultati i pritur nr.6,7.8.</p>
	Java e pesëmbëdhjetë	<p>Menaxhimi i rrezikut nëpërmjet sigurimit, studime të rasteve nga studentet, analizimi dhe vlerësimi</p> <p>Studime të rasteve rreth menaxhimit, vlerësimit të rrezikut dhe analizës së vendimeve</p> <p>Rezultati i pritur nr.5,7.8.</p>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:		
<p>Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.</p>		